

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Emine Mustafa, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Nebojsa Boriçiç, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit L.I., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga i dënuari L.I., kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm P.nr.352/2017 të datës 26.02.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.499/2018 të datës 28.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 23 gusht 2018, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e të dënuarit L.I., e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj- Departamenti i Përgjithshëm P.nr.352/2017 të datës 26.02.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1.nr.499/2018 të datës 28.05.2018.

### A r s y e t i m

#### **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Ferizaj - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.352/2017 të datës 26.02.2018, të dënuarin L.I. e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj, i cili dënim është shndërruar me dënim me gjobë në lartësi prej 800 (tetëqind) €. Është obliguar për pagesën e paushallit gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) €, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PA1.nr.499/2018 e datës 28.05.2018, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit dhe e ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur i dënuari, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovojë si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe ti shqiptoj dënim me kusht.

### **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.nr.132/2018 e datës 24.07.2018, ka propozuar që kërkesa të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë i dënuari thekson se dënimi i shqiptuar me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe i vërtetuar nga gjykata e shkallës së dytë përmban shkelje të ligjit penal në dëm të tij, pasi që dënimi i shqiptuar është shumë i lartë dhe me rastin e shqiptimit të dënimit nuk është marrë parasysh rrethana e pranimit të fajësisë, pendimi i thellë dhe se është hera e parë që ka kryer vepër penale, meqë po të çmoheshin këto rrethana të dënuarit do ti shqiptohej dënim më i butë përkatësisht dënim i kushtëzuar apo vërejtje gjyqësore.

Pretendohet po ashtu se dënimi i shndërruar me gjobë është shumë i lartë dhe me këtë rast po ashtu nuk janë çmuar mjaftueshëm rrethanat lehtësuese se i dënuari është mbajtës i vetëm i familjes së tij me bashkëshorten dhe një fëmijë si dhe me të dy prindërit e sëmurë për të cilët duhet të kujdeset vazhdimisht e po ashtu se me të dëmtuarin ka përmirësuar raportet duke i ofruar ndihmë pas kryerjes së veprës penale.

## **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimi i mbrojtësit të të dënuarit është i pabazuar, ngase aktgjykimet e kundërshtuara, nuk përmbajnë shkelje të pretenduara të ligjit penal.

Në rastin konkret është e rëndësishme të theksohet se i dënuari ka bërë pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar dhe si rezultat i konstatimit të gjykatës se janë përmbushur kriteret e përcaktuara në nenin 248 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është aprovuar dhe shqyrtimi fillestar ka vazhduar me shqiptimin e dënimit, ashtu që pasi që të dënuarit i është shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) muaj e pas kësaj me pëlqimin e tij dënimi me burgim i është shndërruar në dënim me gjobë në lartësi prej 800 (tetëqind) €, ashtu siç është konstatuar pas shpalljes së aktgjykimit në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor.

Bazuar në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë rezulton se me rastin e shqiptimit të dënimit janë çmuar mjaftueshëm të gjitha rrethanat lehtësuese për të shqiptuar dënim adekuat përkatësisht për të individualizuar dënimin. Me këtë rast janë marrë si rrethana lehtësuese pranimi i fajësisë, pendimi i të dënuarit dhe raportet e përmirësuara mes të dënuarit dhe të dëmtuarit e po ashtu edhe rrethanat personale se i dënuari është i martuar dhe baba i një fëmije dhe bazuar në faktin se në rastin konkret nuk janë gjetur rrethana rënduese me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se me anë të këtij dënimi të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen i dënuari të mos kryej vepra tjera penale si dhe do të ndikoj edhe te personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale.

Gjykata Supreme e Kosovës, konstatojë se konform dispozitës se nenit 385 par.5 të KPPK, kur është fjala për vendimin për dënim, shkelje e ligjit penal bëhet kur në marrjen e vendimit për dënim, dënimi alternativ, vërejtja gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, gjykata ka tejkalluar kompetencat ligjore.

Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar llojin e dënimit të paraparë për këtë vepër penale gjegjësisht dënimin me burgim brenda minimumit dhe maksimumit të paraparë me ligj, kështu që pretendimi i të dënuarit i paraqitur në kërkesë se aktgjykimi është përfshirë në shkelje të ligjit penal nuk është i bazuar.

Pretendimet e theksuara përkitazi me shkeljet e dispozitave esenciale të procedurës penale edhe pse është cekuar si shkelje, megjithatë në kërkesë nuk është paraqitur asnjë pretendim konkret, andaj, kjo pikë e kërkesës nuk u trajtua, bazuar në nenin 436 par.1 të KPPK-së, se me rastin e vendosjes së kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve në të cilat pretendon paraqitësi i kërkesës.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.181/2018, më 23 gusht 2018

Procesmbajtësi,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Emine Mustafa